



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 të datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

PROPOZIM

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e dates 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 si dhe nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 12 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2022, të miratojë këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE SHOQATËS SINDIKALE TE ADMINISTRATËS KOMUNALE

Neni 1

I ipet pëlqimi Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare, në shumë prej 8000 €, (tetë mijë) euro Shoqatës Sindikale të pavarur e Administratës Komunale, sipas kërkesës së tyre të datës 17.03.2022, me qëllim të mbështetjes financiare për realizimin e vizitës dy ditore në Republikën e Shqipërisë të gjithë stafin punues të Administratës Komunale .

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2022.

Neni 3

Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Shoqata Sindikale e pavarur e Administratës Komunale i ka parashtruar kërkesë Kryetarit të Komunës me date 17.03.2022, me të cilën kanë kërkuar mbështetje financiare për realizimin e vizitës dy ditore në Republikën e Shqipërisë për të gjithë të punësuarit në kuadër të Administratës Komunale e cila vizitë planifikohet të realizohet në muajin maj të këtij viti .

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të Kërkesës së lartëcekur në pajtim me dispozitën e nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019 për të mar Vendim për ndarjen e mjeteve kërkon nga Kuvendi dhënien e pëlqimit pasi është fjala për kërkesë që tejkalon shumën mbi 2000€ .

1Nr. 01-011/01-14567

Lipjan, më 17.03.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



Pranuar më: 17-03 2022		
Prilbjen:		
Njësia Jednic:	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-400/01-14548		



PËR : Z. IMRI AHMETI KRYETAR I KOMUNËS

NGA : SHEMSI AZEMI KRYETAR I SHOQATËS SINDIKALE TË ADMINISTRATËS
KOMUNALE NË LIPJAN *per Shemsi*

MË : 17.03.2022

NR.

KËRKESË

I nderuar, Kryetar

Me anë të kësaj kërkesë kërkojmë nga ana e juaj që të na mbështesni brenda mundësive tuaja financiare për realizimin e Projektit të SHSPAK sipas të cilit kemi planifikuar;

Realizimin e një vizite dy ditore në Republikën e Shqipërisë të cilën planifikojmë ta realizojmë në muajin maj të këtij viti.

Në këtë vizitë planifikojmë të marrin pjesë të gjithë të punësuarit e Administratës Komunale.

Kostoja e përafërt për realizimin e këtij projekti është përafërsisht 8000 Euro.

Pasi ne si Shoqatë Sindikale e Administratës Komunale nuk po kemi mundësi nga mjetet e grumbulluara nga anëtarët ti mbulojmë këto shpenzime

Mbesim me shpresë se kërkesa jonë do të aprovohet pozitivisht.